



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice
Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 52/2017
Datë: 24.03.2017

Në mbështetje të neneve 4,21,22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 323 paragrafi 1, nenit 328 paragrafi 1 dhe nenit 330 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, si dhe nenin 126.1.2 pika a) nenin 129, të Ligjit për Procedurën Administrative 02/1-28 (22/7/2005) Ministria e Drejtësisë merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e kandidatit Kushtrim Metaj nga Prishtina, nr. 02-352 të datës 03.02.2017.
- II. Anulohet Vendimi NR. 5/2017 dt. 23.01.2017.
- III. Kandidati Kushtrim Metaj nga Prishtina, emërohet Përmbartues Privat për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Ministrisë të Drejtësisë Nr.5 dt.23.01.2017, është hedhur si e pas afatëshme kërkesa e kandidatit Kushtrim Metaj datës 14.12.2016 për emërimin Përmbartues Privat, e paraqitur në Ministrinë e Drejtësisë për emërim për Përmbartues Privat për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, me arsyetim se aplikimi është bërë jashtë afatit të përcaktuar në konkurs i cili është publikuar me datë 14.11.2016 në dy gazetatat ditore dhe është mbyllur me datën 13.12.2016, e në kundërshtim me nenin 328 paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

Kundër aktvendimit sipërcituar, Kushtrim Metaj me dt. 03.02.2017, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim dhe anulim të aktvendimit Nr.5, dt. 23.01.2017, me arsyetim se gabimisht është zbatuar e drejta materiale kur kërkesa e tij për emërimin e Përmbartuesit privat është hedhur si e pas afatëshme.

Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim dhe shkresave të lëndës, gjeti se: Kërkesa për rishqyrtim është e bazuar.

Komisioni për vlerësimin e kandidateve duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit Nr.5 dt. 03.02.2017, ka gjetur se e njëjta nuk është në harmoni me dispozitën e nenit 122 pika a) të Ligjit për Procedurën Administrative 02/1-28 (22/7/2005), ku është paraparë se në llogaritjen e afateve për zbatimin e aktit administrativ nuk përfshihet dita në të cilën del akti.

Për më tepër edhe me dispozitën e nenit 126.2 të LPK-së, (i aplikueshëm në bazë të dispozitës së neni 63 të Ligjit Nr.03/L-202 Për Konfliktin Administrativ), është paraparë që nëse afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme. Kjo nën kupton se kur afati është caktuar në ditë, atëherë fillimi i afatit llogaritet në orën 00.00 të ditës në vijim nga dita, kur ndodhë ngjarja e caktuar. Si ngjarje në kuptim të kësaj norme merret dita e parë e ardhshme. Në rastin konkret afati i konkursit ka qenë 30 ditë nga dita e shpalljes së konkursit. Konkursi është shpallur me datë 14.11.2016, kurse për fillim të afatit, merret dita e parë e ardhshme, konkretisht data 15.11.2016, kështu që kërkesa për aplikim e kandidatit është dorëzuar në afatin e paraparë në konkurs me datë 15.11.2016. Prandaj, nga arsyet e cekura si më lartë është miratuar si e bazuar kërkesa për rishqyrtim.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara, vendimi i kundërshtuar u deshtë të anulohet në mbështetje të nenit 122 pika a), nenin 132 dhe nenin 122 pika a) të Ligjit për Procedurën Administrative, andaj u vendos si në pjesën II të dispozitivit të vendimit.

Komisioni po ashtu vlerëson se kandidati Kushtrim Metaj nga Prishtina, i plotëson kushtet ligjore për tu emëruar si Përmbartues Privat për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, andaj në mbështetje të nenit 329 dhe nenit 330.1 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (Nr. 3, me datë 31.01.2013), vendosi si në pjesën III të dispozitivit të vendimit.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dhurata Hoxha
Ministre e Drejtësisë



Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi mund të ngritet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministres;
- Palës;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë;
- Departamentit për Profesionet e Lira.